

**Universiteti i Saarland-it në Gjermani ofron bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.**

*\*Këto bursa do të ofrohen sipas parimit: First Come, First Served.*

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

- Bachelor (1 semestër);
- Master (1 semestër);

**Fushat e studimit:**

<https://www.uni-saarland.de/nc/startseite.html>

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

- CV (në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare);
- Listë notash (të përkthyer në mënyrë zyrtare);
- Letër Motivimi në gjuhën angleze/gjermane;
- Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Gjermanisht në varësi të programit të studimit në Universitetin e Saarland-it);

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- CV (në gjuhën angleze/gjermane);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare);;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (të përkthyer në mënyrë zyrtare);
- Listë notash e nivelit Master (të përkthyer në mënyrë zyrtare);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/gjermane;

-Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Gjermanisht në varësi të programit të studimit në Universitetin e Saarland-it);

Afati për aplikim: **09 Maj 2019**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al) me subjekt: “Aplikim për bursë në Universitetin e Saarland, emrin dhe mbiemrin tuaj”.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!